



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 105 Nr. ifaq/Br.str./No.pg 1/31

Data/Datum/Date 31.07.2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.7.2023, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës 02 Nr. /958/23, i datës 6.7.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Vrajak, në vendin e quajtur arash-izbeg, me kulturë Kullosë e Klasës 3, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510011-00171-0, në sipërfaqe prej 3500m<sup>2</sup> (tre mijë e pesëqind metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4789m<sup>2</sup> (katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim-të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afatshkurtër për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, mbi baza mujore, përcaktohet nga komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

**Vendimi u dërgohet:**

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

01-Nr.105/23  
Me datë: 31.7.2023

